



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN
E LARTË**

**Raporti i Akreditimit Institucional të Akademisë së
Filmit dhe Multimedias Marubi**

Dhjetor 2019

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

1. Z. Kevin Kendall Kryetar
2. Dr. Benita Stavre Anëtare

Përmbajtja

Tabela e përmbajtjes

Rreth këtij vlerësimi	4
Raport i përmbledhur.....	6
Praktika e mirë	8
Dobësitë	9
Rekomandime	9
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	9
Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi	10
Gjykim i përmbledhur	10
Raporti i detajuar	11
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	11
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet.....	15
Gjetjet	18
Praktika e mirë	18
Dobësitë	18
Rekomandime	18
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	18
Gjykimi	18
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula.....	19
Praktika e mirë	22
Dobësitë	23
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	23
Gjykimi	23
Gjetjet	26
Praktika e mirë	26
Dobësitë	26
Rekomandime	26
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	26
Gjykimi	26
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	27
Gjetjet	29
Praktika e mirë	29
Dobësitë	29
Rekomandime	29
Pohimi i veprimeve të ndërmarra	30
Gjykimi	30
Lista e evidencave	30

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle Akademia e Filmit dhe Multimedia Marubi përmbush Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve ndërkombëtarë me përvojë në arsimin e lartë dhe e ekspertëve shqiptarë, të caktuar nga ASCAL-i. Grupi i vlerësimit të jashtëm drejtohet nga një ekspert i ASCAL-it.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi, por edhe për t'iu ofruar palëve të interesit, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruhet e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë janë grupuar nën pesë Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar ASCAL-it dhe Bordit të Akreditimit një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, ASCAL-i i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Akademia e Filmit dhe Multimedia Marubi (AFMM) është një institucion jopublik i pavarur i arsimit të lartë profesional në fushën e kinematografisë dhe televizionit në Shqipëri, i themeluar në vitin 2004 nga shtëpia kinematografike Orafilm. AFMM-ja synon të trajtojë specialistë dhe të ofrojë kualifikime në fushën e filmit dhe multimedias, dhe të krijojë programe audiovizuale të lidhura direkt me filmin dhe televizionin. Në shkurt të vitit 2017,

qeveria shqiptare, së bashku me shtëpinë kinematografike Orafilm, bashkëthemeluan Fondacionin Kinostudio, i cili menaxhon Akademinë. Institucioni u riorganizua dhe mori Statusin e Veçantë nga Këshilli i Ministrave në prill të vitit 2018. AFMM-ja ka qëllimet e mëposhtme:

- Zbulimin, përgatitjen dhe kualifikimin e talenteve të reja në industrinë audiovizuale dhe të filmit.
- Shkëmbimin e kontakteve dhe aftësive rajonale ndërmjet talenteve në Evropën Juglindore.
- Përmirësimin e aftësive teknike dhe krijuese në rajon.
- Përmirësimin e imazhit në sferën ekonomike, tregtare dhe artistike në Shqipëri dhe në rajon.
- Rigjallërimin e procesit industrial të filmit.
- Sigurimin e teknikëve të kualifikuar për industrinë e medias dhe filmit.

AFMM-ja ka një fakultet dhe ofron një program të ciklit të parë që ofron diplomë Bachelor si Specialist i Lartë në Film dhe Media, në profilet Regjisorë, Skenar, Kamera dhe Montazh, e cila është tema që reflekton aftësi të specializuara të përzgjedhura për zhvillim nga studentët. AFMM-ja ndodhet në Tiranë, në zonën e njohur si Kinostudio; edhe Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit ndodhet po aty pranë. Ajo është në pronësi të shtetit, dhe më parë ka qenë studio shtetërore e filmit që siguronte salla të dobishme për shfaqje dhe studio me izolim akustik. AFMM-ja është anëtare e CILECT (Shoqata Ndërkombëtare e Shkollave të Filmit dhe Televizionit) dhe ka një larmi lidhjesh ndërkombëtare. Shumë prej studentëve të AFMM-së kanë punuar në fushën e filmit dhe televizionit; disa prej tyre menaxhojnë kompanitë e tyre dhe mund të punësojnë të diplomuar të ardhshëm të AFMM-së, ndërsa disa japin mësim me kohë të pjeshme në AFMM.

AFMM-ja ka tre departamente akademike, konkretisht Departamentin e Skenarit dhe Regjisorës, Departamentin e Kameras dhe Montazhit dhe Njësinë e Prodhimit. Prurjet janë kufizuar në vetëm 15 studentë të regjistruar në të gjitha vitet e programit; numri i përgjithshëm ra nga 15 në vitin 2014/15 në 9 në vitin 2015/16, megjithëse u rrit sërish në 15 në vitin 2016/17. Për vitin akademik 2018-2019, në AFMM u regjistruan 12 studentë. Që prej themelimit të AFMM-së në vitin 2004, ajo ka pasur 170 studentë dhe 63 të diplomuar. AFMM-ja ka pasur edhe disa studentë nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Serbia, si dhe nga Shqipëria, dhe do të dëshironte të zgjeronte prurjet e saj me studentë nga vende joshqipfolëse. Pjesa më e madhe e stafit punojnë me kohë të pjeshme pasi janë profesionistë në fushën e filmit dhe medias. Aktualisht, ajo ka katër pedagogë me kohë të plotë dhe 11 pedagogë me kohë të pjeshme. Stafi me kohë të plotë përfshin Drejtorin, Përgjegjës in e Prodhimeve dhe përgjegjës in e dy departamenteve.

Raport i përmbledhur

Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi (AFMM; Akademia) hartoi një raport vetëvlerësimi (RVV), së bashku me dokumentacionin mbështetës, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit. Në RVV pranohej se aspektet e Standardeve Shtetërore të Cilësisë ishin sfidues për AFMM-në, duke argumentuar se ato nuk janë lehtësisht të zbatueshme për një institucion të vogël të specializuar në fushën e filmit dhe medias. Kjo vlen veçanërisht për disa prej standardeve që lidhen me kërkimin, ku nuk u vunë në dispozicion dokumente, dhe që AFMM-ja, si Akademi me status të veçantë, nuk është e detyruar t'i trajtojë. Në RVV pohohet se AFMM-ja kishte vuajtur konkurrencën nga institucione të tjera që ofrojnë më shumë programe studimi teorike, por në të shprehej edhe shpresa se ndryshimet në politikën e qeverisë do të bënin të mundur ecjen përpara të AFMM-së. RVV-ja është e mirëstrukturuar, me referenca të qarta për dokumentet e dorëzuara, dhe ishte shkruar në gjuhën angleze, me rrjedhshmëri të jashtëzakonshme. Megjithatë, i mungonte vlerësimi kundrejt Standardeve dhe nuk jepte sugjerime se çfarë duhej të bënte vetë Akademia me nismën e saj për të trajtuar çdo mangësi në lidhje me Standardet.

Ky është Vlerësimi i tretë Institucional i universitetit për të vlerësuar se në çfarë shkalle janë përmbushur Standardet Shtetërore të Cilësisë, të cilat hynë në fuqi në vitin 2011. Raporti i vlerësimit të parë në prill 2017 identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë, i dha universitetit 12 rekomandime për të konsideruar adresimin e fushave të identifikuara të dobësive dhe nuk pohoi asnjë veprim tashmë në proces. Raporti më i fundit i vlerësimit mund të gjendet në: https://www.ascal.al/media/documents/rvj/IAL_5_75.pdf.

Në raportin e prillit 2017 u dhanë gjykimet e mëposhtme për secilën fushë vlerësimi:

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përmbushur pjesërisht**.
2. Standardet për Burimet janë **përmbushur kryesisht**.
3. Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur kryesisht**.
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur kryesisht**.
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përmbushur kryesisht**.

Në prill të 2017-ës, vlerësuesit i rekomanduan Bordit të Akreditimit se Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi i kishte **përmbushur pjesërisht** Standardet Shtetërore të Cilësisë, dhe për rrjedhojë universiteti do të merrte akreditimin nga Bordi për një periudhë 2-vjeçare.

Raporti i Vetëvlerësimit u hartua nga një Grup Pune i brendshëm i Vetëvlerësimit, pjesë e të cilit ishin tre persona nga Akademia me njohuri të thella në funksionimin e Akademisë, por nuk u përfshi asnjë përfaqësues i studentëve. Grupi i punës u ngrit nga Senati Akademik dhe detyrat e tij u ndanë ndërmjet anëtarëve të grupit. Atyre iu vunë në dispozicion dokumente të brendshme, statute dhe rregullore të universitetit, së bashku me të dhënat statistikore dhe raportet përkatëse. Grupit iu mundësua edhe akses në rekomandimet e Bordit të Akreditimit të dhëna në vlerësimin e vitit 2017. Senati Akademik autorizoi botimin e raportit përfundimtar dhe dërgimin e tij pranë Agjencisë. Raporti i

Vetëvlerësimi ishte një dokument i dobishëm për grupin e vlerësimit të jashtëm, por nuk ishte shumë vetëkritik ose vlerësues në vlerësimin e Akademisë sipas Standardeve të Cilësisë për secilën Fushë Vlerësimi.

Vizita e grupit të vlerësimit të jashtëm u zhvillua në dy ditë, konkretisht më 8 dhe 9 tetor 2019. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhej nga një vlerësues me përvojë i arsimit të lartë nga Mbretëria e Bashkuar dhe një anëtar i stafit me përvojë në arsimin e lartë nga institucioni shqiptar. Grupi i vlerësimit të jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një person që mbante shënime, i vënë në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Grupi i vlerësimit të jashtëm e mori Raportin e Vetëvlerësimit dhe portofolin e evidencave mbështetëse të javë përpara vizitës së vlerësimit, i cili më vonë u plotësua me dokumentacionin shtesë të kërkuar para dhe gjatë vizitës.

Larmia e madhe e informacionit mbështetës e vënë në dispozicion nga universiteti i mundësoi ekipit të njëjve vetë me strukturën, procedurat e menaxhimit dhe natyrën e mësimdhënies, si dhe veprimtarinë kërkimore të kryer. Evidencat përfshinë Statutin dhe Rregulloret, detajet e Statusit të Veçantë, raportet vjetore dërguar Ministrisë, listat e marrëveshjeve të jashtme, partneriteteve dhe memorandumëve, CV-të e pedagogëve, detajet e festivaleve dhe shembuj të informimit për programet. Përpara kryerjes së vizitës, grupi i vlerësimit të jashtëm kërkoi disa dokumente shtesë.

Gjatë vizitës së vlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm u takua me Drejtorin, menaxherët e lartë, studentët, pedagogët, stafin administrativ dhe mbështetës, anëtarët e grupit të vetëvlerësimit dhe alumnin e partnerët e jashtëm, përgjegjësit e departamenteve dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Diskutimet ndihmuan në qartësimin e procedurave, përgjegjësi dhe gjetjeve. Në të gjitha mbledhjet u mbajtën shënime. Si pjesë e turit në burimet e të nxënit, grupi i vlerësimit të jashtëm vizitoi një larmi burimesh, duke përfshirë teatrin, sallën e kontrollit teatral, sallën e miksimit të zërit, laboratorin filmik, sallën e videokonferencave, sallën e kostumeve dhe sallën e teknikës, si dhe bibliotekën dhe strukturat administrative.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ishte në gjendje të konfirmonte se dobësitë dhe rekomandimet përkatëse të identifikuar gjatë vizitës së vlerësimit në prill 2017 në Fushën e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij, po adresohen dhe janë zbutur në njëfarë shkalle me marrjen e Statusit të Veçantë nga Ministria. Rekomandimet në Fushën e Vlerësimit 2: Burimet janë adresuar plotësisht. AFMM-ja ka adresuar edhe dobësinë e Fushës së Vlerësimit 3: Kurrikula, duke pasur parasysh pranimin e katër pedagogëve me kohë të plotë dhe marrjen në konsideratë të specifikimeve të Statusit të Veçantë lidhur me profilin profesional të stafit akademik me kohë të plotë. Rekomandimet e Fushës së Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi, dhe të Fushës së Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre, lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe angazhimin e Këshillit Studentor, mbeten ende për t'u adresuar nga Akademia.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përmbythur kryesisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë, dy dobësi dhe bëri një pohim. Karakteristika e praktikës së mirë lidhet me

përdorimin e Bordit Këshillimor për të ndihmuar në përcaktimin e strategjisë; dobësitë lidhen me nivelin e ulët të efikasitetit të Këshillit Akademik dhe me mungesën e vetëvlerësimit kritik në akademi. Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi progresin e shënuar në adresimin e ndryshimeve që duhet të bëhen në përputhje me dhënien e Statusit të Veçantë nga Këshilli i Ministrave. Megjithatë, grupi i vlerësimit të jashtëm i rekomandon AFMM-së të forcojë rolin e Këshillit Akademik për të pasur më shumë ndikim në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ky i fundit duhet të adoptojë një qasje më vetëkritike për të identifikuar dobësitë dhe për të planifikuar përmirësimet.

Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë, e cila është përdorimi i rrjeteve të gjera të partnerëve për të blerë pajisjet e duhura për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk bëri asnjë pohim.

Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dy karakteristika të praktikës së mirë dhe bëri një pohim. Praktika e mirë lidhet me kontributin e pedagogëve të huaj dhe pjesëmarrjen e studentëve në workshop-e, festivale dhe stazhe çka ndihmon në kalimin e tyre në tregun e punës. Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi nismën e Akademisë për të zgjeruar gamën e kualifikimeve për të përbushur tendencat e reja në tregun e punës.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë praktikë të mirë, asnjë dobësi, dhe as nuk dha rekomandime. Megjithatë, për shkak të mungesë së evidencave dhe pikëpamjes së shprehur nga Akademia se standardet kërkimore nuk janë të përshtatshme për këtë institucion, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk mund të bënte asnjë gjykim për standardet lidhur me kërkimin.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur kryesisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi një dobësi dhe dha një rekomandim. Dobësia lidhet me mungesën e përfshirjes aktive të Këshillit Studentor në procedurat e vendimmarrjes ose në zbatimin e kurrikulës, dhe grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandoi që diçka e tillë të adresohet në mënyrë pozitive.

Akademia e kreu vlerësimin në përputhje me udhëzimet e ASCAL-it dhe përgjatë gjithë vizitës u përdor gjuha angleze. Grupi i vlerësimit të jashtëm vlerëson nivelin e angazhimit të Akademisë në proces dhe bashkëpunimin me grupin e vlerësimit të jashtëm përgjatë fazës së vizitës. Në veçanti, grupi i vlerësimit të jashtëm përgëzon punën e Grupit të Vetëvlerësimit lidhur me ofrimin e bazës së evidencave dhe të Koordinatorit Institucional për vëmendjen që i kushtoi grupit të vlerësimit të jashtëm përgjatë gjithë vizitës. Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhej nga Kevin Kendall (Kryetar) dhe Benita Stavre (Anëtare).

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Përdorimin e Bordit Këshillimor për të përcaktuar strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në AFMM. *(Kapitulli III, Standardi I.1, Standardi I.2).*
- Përdorimin e rrjeteve të zgjeruara të partnerëve për të blerë pajisjet e duhura për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. *(Kapitulli III, Standardi VII.5).*
- Kontributin e pedagogëve të jashtëm për të zgjeruar gamën e kualifikimeve të kurrikulës në profilin e programit studimor. *(Kapitulli I, Standardi I.2 Kapitulli I, Standardi I.4)*
- Pjesëmarrjen në workshop-et profesionale, promovimin e punës së studentëve në festivalet kombëtare dhe ndërkombëtare të filmit, dhe në periudhat e stazhit në institucionet vendase të filmit që mundëson një kalim më të lehtë të të diplomuarve në tregun e punës. *(Kapitulli I, Standardi I.4, Kapitulli I, Standardi I.11, Kapitulli I, Standardi I.12).*

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Këshilli Akademik është përgjegjës për programet, veprimtarinë mësimore dhe të kërkimit shkencor, por ka ndikim të kufizuar praktik në monitorimin, rishikimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. *(Kapitulli III, Standardi I.1, Standardi I.2).*
- Vetëvlerësimi kritik nuk vihet re as gjatë diskutimit me stafin dhe as në Raportin e Vetëvlerësimit. *(Kapitulli III, Standardi I.1, Standardi I.2).*
- Ka evidenca të pakta për përfshirjen aktive të Këshillit Studentor në procedurat e vendimmarrjes ose në zbatimin e kurrikulës. *(Kapitulli I, Standardi III, 7).*

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Të forcohet roli i Këshillit Akademik për të pasur më shumë ndikim në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. *(Kapitulli III, Standardi I.1, Standardi I.2).*
- Akademia të adoptojë një qasje më vetëkritike për të identifikuar dobësitë dhe planifikuar përmirësimet. *(Kapitulli III, Standardi I.1, Standardi I.2).*
- Akademia duhet të promovojë pjesëmarrjen më aktive të përfaqësuesve të studentëve në çështjet e saj organizative dhe duhet të ofrojë feedback të vërtetë për nevojat e nxënësve.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm të ndërmarrë:

- Progresin e mirë të shënuar në adresimin e ndryshimeve në institucion në përputhje me Statusin e Veçantë të dhënë nga Këshilli i Ministrave. (*Kapitulli III, Standardi I.2, Standardi I.3, Standardi I.3*).
- Nisma e Akademisë të zgjerojë gamën e kualifikimeve të ofruara për të përmbushur tendencat e reja në tregun e punës. (*Pika III.5, Kapitulli I, Standardi I.4*).

Përmbledhje e gjykrimeve për çdo Fushë Vlerësimi

1. Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përmbushur kryesisht**.
2. Standardet për Burimet janë **përmbushur plotësisht**.
3. Standardet për Kurrikulën janë **përmbushur plotësisht**.
4. Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përmbushur plotësisht**.
5. Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përmbushur kryesisht**.

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi i ka **përmbushur kryesisht** Standardet Shtetërore të Cilësisë.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 AFMM-ja ka një Statut të ri [1], i cili u miratua nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në korrik të vitit 2018 [2]. Akademia mori Statusin e Veçantë nga Këshilli i Ministrave në prill të vitit 2018 [3]. Vendimi u mor pasi Akademia është një institucion jopublik i arsimit të lartë me veprimtari të veçanta akademike të shoqëruara me organizimin dhe zhvillimin e mësimdhënies së proceseve krijuese dhe artistike në fushën e kinematografisë dhe multimedias. Statuti [1] dhe rregulloret shoqëruese [4] janë hartuar dhe miratuar në përputhje me Statusin e Veçantë [4]. *(Kapitulli III, Standardi I.1).*

1.2 Struktura organizative detajohet në Statut [1] dhe përfshin Drejtorin, Drejtorin Administrativ, Përgjegjës të Prodhimeve, Këshillin Akademik dhe Bordin Këshillimor. Drejtori është njëkohësisht themeluesi dhe përgjegjësi i shtëpisë kinematografike Orafilm. Përgjegjësi e departamentit mbajnë përgjegjësi para Drejtorit nëpërmjet Këshillit Akademik. Gjithashtu, ekziston edhe Këshilli Studentor. Sipas Statutit [1] dhe Rregulloreve [4], Drejtori harton programin e zhvillimit, programin vjetor të veprimtarive, shpërndan buxhetet, materialet dhe burimet njerëzore, miraton rregulloret, nënshkruan të gjitha kontratat dhe emëron të gjithë stafin. Përgjegjësi i Prodhimeve të AFMM-së menaxhon Njësinë e Prodhimit, ndërsa Drejtori Administrativ është përgjegjës për buxhetin, organizimin, koordinimin dhe kalendarin. Akademia ngriti edhe dy komisione të posaçme për qëllime të këtij vlerësimi, konkretisht Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [M10] dhe Grupin e Vetëvlerësimit [M13]. Gjithashtu, edhe pse këto grupe mund të flasin me kompetencë për strukturën, organizimin dhe menaxhimin e Akademisë, **vetëvlerësimi kritik nuk vihet re as në diskutimet me stafin dhe as në Raportin e Vetëvlerësimit (referuar pikës 4.3 dhe 4.4) [M10, M13, RVV], dhe grupi i vlerësimit të jashtëm i rekomandon Akademisë të adoptojë një qasje më vetëkritike për të identifikuar dobësitë dhe planifikuar përmirësimet. (Kapitulli III, Standardi I.1, Standardi I.2).**

1.3 Këshilli Akademik përbëhet nga të paktën tre anëtarë të stafit akademik dhe Drejtori i AFMM-së, i cili është anëtar i përhershëm dhe ka fuqinë e vetos. Përgjegjësi i Këshillit Akademik zgjidhet dhe është anëtar i përhershëm i Komisionit të Etikës dhe Disiplinës. **Këshilli Akademik është përgjegjës për programet, veprimtarinë mësimore dhe të kërkimit shkencor, por ka ndikim të kufizuar praktik në monitorimin, rishikimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënies të Akademisë [11, G, M3, M4, M10] dhe grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandoi forcimin e rolit të Këshillit Akademik për të pasur më shumë ndikim në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.** Këshilli Studentor përfshin tre anëtarë të zgjedhur dhe përfaqësues të studentëve të AFMM-së; megjithatë, grupi i vlerësimit të jashtëm vuri re evidenca të pakta të përfshirjes aktive të Këshillit Studentor në procedurat e vendimmarrjes ose në zbatimin e kurrikulës (referuar pikës 5.7). Bordi Këshillimor përbëhet nga përfaqësues të partnerëve, duke përfshirë një përfaqësues të Shoqatës së Kineastëve Shqiptarë Lumiere dhe një përfaqësues të partnerëve ndërkombëtarë të AFMM-së. Gjithashtu, përfshin edhe një përfaqësues të stafit akademik dhe një përfaqësues të zgjedhur nga Këshilli Studentor. Bordi e këshillon AFMM-në për politikën dhe strategjitë afatshkurtra,

afatmesme dhe afatgjata. **Grupi i vlerësimit të jashtëm e konsideron përdorimin e Bordit Këshillimor për të përcaktuar strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në AFMM si një karakteristikë të praktikës së mirë** dhe kjo duhet të mbështetet në të ardhmen. AFMM-ja mbështet debatin nëpërmjet Bordit të saj dhe Strukturës së Komisionit **[A]**, dhe për diskutimet mbahen procesverbale dhe në këto mbledhje merren edhe vendime **[11]**. *(Kapitulli III, Standardi I.1, Standardi I.2, Standardi II.3).*

1.4 AFMM-ja ushtron veprimtarinë e saj në një fushë të specializuar, kështu që ka një fakultet, konkretisht Fakultetin e Filmit dhe Medias, i cili ndahet në tre departamente: Departamenti i Skenarit dhe Regjisurës, Departamenti i Kameras dhe Montazhit, dhe Njësia e Prodhimit. Përgjegjësi i Prodhimeve është edhe Drejtor Ekzekutiv i shtëpisë kinematografike Orafilm. Ai është përgjegjës për të gjitha pajisjet teknike dhe kinematografike që përdoren në prodhimet e studentëve. AFMM-ja nxit debatin konstruktiv nëpërmjet të gjitha strukturave të mësipërme, dhe grupi i vlerësimit të jashtëm **pohon progresin e mirë të shënuar në adresimin e ndryshimeve në institucion në përputhje me Statusin e Veçantë të dhënë nga Këshilli i Ministrave [3]**. *(Kapitulli 111, Standardi 1.2, Standardi 1.3).*

1.5 AFMM-ja respekton kufijtë e saj të autonomisë, por ka partneritete të forta me përfaqësues të huaj në Shqipëri dhe ka marrë më parë financim nga Bashkimi Evropian **[RVV]**. Partneritetet përfshijnë Institutin e Filmit (FIOFA), Parlamentin e Shqipërisë, Fondacionin M.A.M., Shkollën Ndërkombëtare të Filmit në Këln (Internationale Filmschule Koln), Shkollën Helenike dhe të Televizionit Stavrakos (Hellenic and Television School Stavrakos) dhe Festivalin Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut (IHRFFA) **[6a-m]**. *(Kapitulli III, Standardi I.4).*

1.6 Akademia ka një plan financiar 5-vjeçar shumë bazik **[57]**, sipas të cilit supozohet një dyfishim i numrit të studentëve dhe një rritje me 50% e të ardhurave të tjera. Gjithashtu, ai përfshin një Strategji Zhvillimore të shkurtër **[B]** me plane afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Megjithatë, stafi akademik dhe Përgjegjësit e Departamentit, me të cilën diskutoi grupi i vlerësimit të jashtëm, nuk i dinë detajet e tyre **[M4, M9]** dhe nuk ka asnjë plan veprimi. Këto përfshijnë rritjen e ndërkombëtarizimit, hapjen e një departamenti të ri, zgjerimin e programeve shumëgjuhëshe dhe zgjerimin e mjediseve ekzistuese. Në mbështetje të këtyre objektivave, Akademia është anëtare e Shoqatës Ndërkombëtare e Shkollave të Filmit dhe Televizionit (CILECT) **[6a]**. *(Kapitulli III, Standardi I.5).*

1.7 Çdo vit, Akademia publikon dhe i dorëzon Ministrisë së Arsimit dhe Sportit **[8]** një Raport Vjetor **[8a-f]**. Ky raport hartohet nga Drejtori Administrativ me mbështetjen e Drejtorit të Prodhimit dhe stafit akademik, dhe rishikohet e nënshkruhet nga Drejtori. *(Kapitulli III, Standardi I.6).*

1.8 AFMM-ja iu mundëson stafit akademik dhe studentëve krijimtarinë dhe lirinë e shprehjes në prodhimet e tyre të filmit dhe televizionit. Studentët studiojnë lëndët bazë në vitin 1 **[O]** dhe gjatë viteve pasuese mund të specializohen në regjisorë, skenar, kamera ose montazh. Zakonisht, stafi akademik përbëhet nga profesionistë të industrisë së kinematografisë, dhe shumë prej tyre janë me kohë të pjesshme, ata punësohen për përvojën e tyre në industrinë

kinematografike **[10a-t]**. AFMM-ja ka faqen e vet të internetit [www.afmm.edu.al], e cila është e disponueshme si në gjuhën angleze ashtu edhe në atë shqipe. Ajo ka detaje, për shembull për organizimin e Akademisë, programet që ofron, partnerët e saj, aktivitetet e organizuara dhe pranimet. **(Kapitulli 111, Standardi 11.1).**

1.9 AFFM-ja ka lidhje të ngushta me industrinë e filmit dhe multimedias në Shqipëri, dhe është në kontakte me ish studentët që janë punësuar në këto industri **[12]**. Anëtarësimi në CILECT që prej vitit 2008, i mundëson asaj të ketë kontakte me shkollat e filmit në nivel ndërkombëtar. Kjo lehtëson pjesëmarrjen në konferencat vjetore, workshop-et dhe festivalet me stafin dhe studentët, **[13, 16a-g]** si dhe partneritetet **[6]**. Shkollat partnere ofrojnë mundësinë për projekte të përbashkëta në filma me metrazh të shkurtër **[14]**. Filmat e partnerëve shfaqen pa pagesë për studentët dhe publikun e gjerë dhe janë të disponueshëm nëpërmjet shumë platformave elektronike, duke përfshirë faqet e internetit të partnerëve. Pedagogët e huaj vizitojnë Akademinë për të zhvilluar workshop-e dhe masterklasa **[15]**. Që prej vitit 2006, Akademia ka organizuar Festivalin e përvitshëm të Filmit për të Drejtat e Njeriut, i cili përfshin shfaqjen e rreth 50 filmave në vendndodhje të ndryshme në Tiranë dhe mbështetet nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare **[Faqja e internetit e IHRFF-së]**. Drejtori i AFMM-së është edhe Drejtori Ekzekutiv i IHRFF-së. **(Kapitulli III, Standardi II.1, Standardi III.2, Standardi III.3).**

Praktika e mirë

- Përdorimin e Bordit Këshillimor për të përcaktuar strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në AFMM. **(Kapitulli III, Standardi I.1, Standardi I.2).**

Dobësitë

- Këshilli Akademik është përgjegjës për programet, veprimtarinë mësimore dhe të kërkimit shkencor, por ka ndikim të kufizuar praktik në monitorimin, rishikimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. **(Kapitulli III, Standardi I.1, Standardi I.2).**
- Vetëvlerësimi kritik nuk vihet re as gjatë diskutimit me stafin dhe as në Raportin e Vetëvlerësimit. **(Kapitulli III, Standardi I.1, Standardi I.2).**

Rekomandime

- Të forcohet roli i Këshillit Akademik për të pasur më shumë ndikim në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. **(Kapitulli III, Standardi I.1, Standardi I.2).**
- Akademia të adoptojë një qasje më vetëkritike për të identifikuar dobësitë dhe planifikuar përmirësimet. **(Kapitulli III, Standardi I.1, Standardi I.2).**

Pohime

- Progresin e mirë të shënuar në adresimin e ndryshimeve në institucion në përputhje me Statusin e Veçantë të dhënë nga Këshilli i Ministrave. **(Kapitulli III, Standardi I.2, Standardi I.3).**

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 Struktura organizative e Akademisë **[A]** është mjaft e thjeshtë për shkak se është një institucion i vogël dhe ka Statusin e Veçantë **[1, 2, 3]**, të dhënë nga Këshilli i Ministrave. Faqja e internetit paraqet detaje lidhur me pozicionet e stafit me kohë të plotë dhe të stafit të punësuar me kohë të pjesshme **[<https://afmm.edu.al/faculty/>]**. Pedagogët në Akademi janë të punësuar me kohë të pjesshme, për shkak se janë profesionistë aktivë në profesionet e tyre **[10a-m]**, dhe janë të nevojshëm në periudha të caktuara për modulet **[O, M2, M4, M12]**, kështu që nuk ka punë të disponueshme me kohë të plotë. Pedagogët me kohë të pjesshme kontaktohen nëpërmjet kontakteve personale dhe reklamimit në faqen e internetit. Ata duhet të paraqesin evidenca për përvojën dhe kualifikimet e duhura nëpërmjet një CV-je, dhe emërohen për gjithë vitin pas kryerjes së një interviste me Drejtorin **[M4, M5, M9]**. Më pas, atyre iu ofrohet një kontratë **[18, M4, M5]** në përputhje me ligjin në Shqipëri. Akademia mban edhe një bazë të dhënash me CV-të e stafit akademik me kohë të pjesshme të kualifikuar si duhet **[M5]**. Gjithashtu, Akademia rekruton pedagogë të huaj, veçanërisht për të zhvilluar masterklasa dhe workshop-e **[15, 32, M4]**. *(Kapitulli III, Standardi IV.1).*

2.2 Akademia është një institucion i vogël, dhe rrjedhimisht stafi është ngushtësisht i integruar dhe shumë prej tyre luajnë shumë role **[M4, M5, M9]**. Studentët aktualë dhe ish studentët me të cilët u takua grupi i vlerësimit të jashtëm janë shumë komplimentues për atmosferën familjare në Akademi dhe mundësitë e disponueshme për ata që kanë mundësinë të përfitojnë prej tyre **[M3, M7]**. Jeta sociale e Akademisë përqendrohet kryesisht në industrinë e kinematografisë dhe filmit, dhe tregohet nëpërmjet ndjekjes së shfaqjeve dhe festivaleve të filmit nga ana stafi dhe studentët **[16a-g]**. Stafi është i përfshirë me aktivitete të tjera **[28]** gjatë vitit, siç reklamohen në faqen e internetit të Akademisë **[<https://afmm.edu.al/events/>]**. Disa studentë janë kthyer të punojnë në Akademi, pasi kanë fituar përvojë dhe kualifikime të mëtejshme në Shqipëri ose jashtë vendit **[RVV]**. Rrjedhimisht, Akademia ka një strukturë administrative që ushtron funksionet e interesit të përbashkët *(Kapitulli III, Standardi IV.2, Standardi VII.6).*

2.3 Pedagogët e rinj me kohë të pjesshme zhvillojnë orë mësimore për studentët si pjesë e procesit të rekrutimit, dhe marrin feedback nga stafi dhe studentët **[M9]**. Po ashtu, studentët plotësojnë pyetësorë mbi cilësinë e mësimdhënies së ofruar **[46, M3, M12]**. Megjithatë, pedagogët me të cilët u takua grupi i vlerësimit të jashtëm u shprehën se nuk kanë dijeni për këtë **[M4]**. Duke qenë se ka një numër të vogël studentësh, ata takohen rregullisht me stafin, si në mënyrë formale edhe në mënyrë joformale, dhe stafi ka mundësi të marrë feedback prej tyre **[M10]**. Akademia e mbështet stafin të vijoje punën e tij në industrinë e filmit, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë vendit, por nuk ofron asnjë trajnim specifik në pedagogji **[M4]**. *(Kapitulli III, Standardi IV.3).*

2.4 Shfaqjet e filmave, të cilat zhvillohen tre herë në javë, janë aktivitete të rëndësishme sociale, kulturore dhe arsimore për Akademinë. Stafi, studentët dhe familjet e tyre, si dhe publiku i gjerë, kanë mundësi që t'i ndjekin ato **[RVV, M3]**. Një tjetër aktivitet social i rëndësishëm është Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut, i cili është organizuar

për 14 vjet nga Akademia, dhe pedagogët përfshihen në planifikimin dhe organizimin e punës për këtë aktivitet **[RVV, <https://ihrffa.net/team/>]**. Gjatë vitit, Akademia organizon edhe aktivitete të tjera, për shembull Festën e Dhuratave të Krishtlindjeve **[RVV]**, ku të gjitha këto aktivitete ndihmojnë për të siguruar një atmosferë familjare ndërmjet stafit dhe studentëve. **(Kapitulli 111, Standardi 1V.4)**.

2.5 Akademia mundëson menaxhimin efikas të burimeve njerëzore, dhe ka rregulla të qarta për të përcaktuar përgjegjësitë sipas funksioneve përkatëse. Kjo është bërë e qartë edhe në the Statut **[1]** dhe Rregulloret **[4]** e Akademisë, si dhe në kontratat individuale të stafit **[M4]** ose në marrëveshjet e shërbimit. Për punësimin me kohë të pjesshme, punësimin me kohë të plotë dhe marrëveshjet e shërbimit përdoren modele kontratash **[18]**. **(Kapitulli III, Standardi II.2)**.

2.6 Të ardhurat kryesore mblihen nëpërmjet tarifave studentore, ndërsa të ardhurat e tjera mblihen nga donacione dhe aktivitete kulturore. Koston kryesore e zë rekrutimi i stafit, e ndjekur nga autorizimi, mallrat e konsumit dhe shërbimet **[19]**. Duke qenë se ka vetëm një fakultet dhe departamentet janë krijuar rishtazi, buxheti i mëparshëm është menaxhuar nga Drejtori, Drejtori Administrativ dhe Përgjegjësi i Prodhimeve sipas zërave përkatës të buxhetit **[RVV]**. Menaxhimi i buxhetit i delegohet Financierit **[RVV, M5]** dhe Këshilli Akademik miraton buxhetin përfundimtar **[M5]**. Stafi akademik pohon se nuk kanë kontribut në buxhet, por e kanë mundësinë të kërkojnë nëse kanë nevojë për burime **[M4]**. AFMM-ja ofron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare dhe kontrollin buxhetor sipas ligjeve të përshtatshme në Shqipëri. Akademia i nënshtrohet procesit të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, por llogaritë e audituara nuk bëhen publike, për shembull në faqen e internetit. **(Kapitulli III, Standardi VI.1, Standardi VI.2, Standardi VI.3)**.

2.7 Akademia ka një faqe interneti [www.afmm.edu.al], e cila është kryesisht në gjuhën angleze dhe ofron detaje, për shembull për qëllimet e Akademisë, metodologjinë e mësimdhënies, mësuesit, menaxherët, pajisjet, programet e ofruara, pranimet, aktivitetet dhe partnerët. Aktualisht, ajo nuk jep asnjë detaj për organizimin e Akademisë, statutin, rregulloret ose informacionin financiar. Stafi dhe studentët në Akademi përdorin email-in për të komunikuar, si dhe grupet online të komunikimit dhe thirrjet telefonike **[RVV, M5]**. Metoda kryesore e komunikimit për çështjet administrative, si oraret, oraret e provimeve dhe rezultatet, festivalet dhe aktivitetet, është këndi i informimit në një vendndodhje të dukshme në mjediset e Akademisë, për të cilin kujdeset Drejtori Administrativ **[M3, M4, M5]**. Numri i vogël i studentëve nuk e justifikon blerjen e sistemit të integruar të teknologjisë së informacionit (TI), por Akademia ka një faqe në Facebook [<https://www.facebook.com/AFMMarubi/>], një në Instagram [https://www.instagram.com/afm_marubi/], dhe një në YouTube [<https://www.youtube.com/user/afmmtv>]. **(Kapitulli III, Standardi VII.1)**.

2.8 Strukturat kompjuterike janë të përshtatshme për lëndët e zhvilluara dhe numrin e studentëve Wi-Fi është i disponueshëm në të gjitha mjediset, ka 15 kompjutera, tetë nga të cilët gjenden në bibliotekë të lidhur me një printer dhe të aksesueshëm nga studentët 24 orë në ditë **[Vizita]**. Çdo grup i secilit vit akademik ka sallat e tyre të montazhit, të cilat po ashtu janë të lidhura në internet **[Vizita]**. Studentët dhe stafi mund të kenë lidhje elektronike përmes Skype me pedagogët në Shqipëri dhe jashtë saj **[21]**. Akademia ka edhe shumë salla të tjera të

përshtatshme për industrinë e filmit, për shembull një teatër, një sallë të kontrollit teatral, një sallatë të miksimit të zërit, një laborator filmik, një sallë videokonferencash, një sallë kostumesh dhe një sallë të teknikës **[Vizita]**. *(Kapitulli III, Standardi VII.2).*

2.9 AFFM-ja nuk zotëron asnjë pasuri të patundshme, por është në pronësi të shtetit për qëllime të mësimdhënies dhe mësimnxënies në industrinë e kinemasë dhe filmit lidhur me ligjin për kinematografinë **[RVV, Vizita]**. Në shkurt të vitit 2017, qeveria shqiptare, së bashku me shtëpinë kinematografike Orafilm, bashkëthemeluan Fondacionin Kinostudio **[7]**, i cili menaxhon Akademinë. Plani për sigurinë rishikohet çdo vit dhe afishohet në hyrje të godinës **[RVV, Vizita]**. Çdo vit kryhen inspektime të rregullta nga Zyra e Zjarrfikësve dhe jepet autorizimi **[RVV, 22]**. *(Kapitulli III, Standardi VII.3).*

2.10 AFMM-ja mban çdo film të prodhuar nga studentët që prej hapjes së saj në vitin 2004 **[RVV, Vizita, M2]**. Ato ruhen në arkivin e bibliotekës, me referenca emrin dhe vitin e studentit, dhe janë të aksesueshme në mënyrë elektronike **[RVV, Vizita, M2, 23]**. Punimet me shkrim të studentëve mbahen në format të shtypur në dosjen e tyre individuale në Zyrën e Sekretariatit **[23, Vizita]**. *(Kapitulli III, Standardi VII.4).*

2.11 Godina ku ndodhet AFMM-ja ishte Studioja Shtetërore e Filmit gjatë regjimit komunist, çka e bën atë plotësisht të përshtatshme për veprimtarinë e saj aktuale me salla shfaqjeje dhe studio me izolim akustik **[Vizita, RVV]**. Në faqen e internetit **[https://afmm.edu.al/faculty/]** është e disponueshme një listë e plotë e pajisjeve të përshtatshme për prodhimin e filmave të studentëve, si dhe është renditur lista e pajisjeve të vitit 2019 **[25]**. Akademia mban artikuj me interes historik lidhur me industrinë e filmit, si dhe regjistrimin në format digjital **[Vizita]**. Zakonisht, pajisjet janë të dhuruara, për shembull ka një piano pothuajse në çdo sallë **[Vizita]**. Prandaj, Akademia është në gjendje të ruajë një buxhet të ulët nëpërmjet **përdorimit të rrjeteve të zgjeruara të partnerëve për të blerë pajisjet e duhura për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies**, çka grupi i vlerësimit të jashtëm e konsideron praktikë të mirë për të mbështetur qëndrueshmërinë financiare. *(Kapitulli III, Standardi VII.5).*

2.12 Godinat e përdorura nga Akademia ishin zyrtarisht studio kinematografike historike dhe janë shndërruar nga Orafilm me mbështetjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) dhe u hap në vitin 2004 **[RVV, Vizita]**. Ato u rikonstruktuan me materiale bashkëkohore që përmbushin standardet e higjienës dhe cilësisë për studentët dhe stafin **[26, 27]**. Ato përfshijnë salla të përshtatshme për orë mësimore teorike dhe praktike në lëndët kinematografike dhe të filmit, plus zona të argëtimit, tualete, dushe, kopsht dhe parkim **[RVV, Vizita]**. Ambientet ofrojnë një mjedis të mirë të mësimnxënies dhe nuk ndodhen afër zonave të zhvillimit industrial **[Vizita]**. Ambientet përmbushin edhe kërkesat minimale të hapësirës dhe normat për ndriçimin, ngrohjen, dhe faktorët e tjerë mjedisorë **[Vizita]**. Megjithatë, sallat e mësimdhënies në katet e sipërme nuk kanë akses për personat me aftësi të kufizuara **[Vizita]**. *(Kapitulli III, Standardi V.1).*

2.13 Ruajtja e dokumentacionit është përgjegjësi e Drejtorit Administrativ. Dosjet e studentëve mbahen në format të shtypur dhe përmbajnë informacion, si formulari i aplikimit, kontratat studimore, rezultatet e vlerësimit, pjesëmarrjen në festivale dhe dosjen e prodhimit të

filmave. Dosjet e pedagogëve përmbajnë CV-të, diplomat, kontratat, kurrikulat, programet mësimore, regjistrat dhe materialet lidhur me lëndët e zhvilluara **[Vizita]**. Drejtori Administrativ ruan regjistrat e studentëve, detajet e kontaktit, diplomat e shkollës dhe notat **[Vizita, 29]**. Këto plotësohen më tej me notat që ruhen edhe në format elektronik **[RVV]**. (**Kapitulli III, Standardi V.2**).

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Përdorimin e rrjeteve të zgjeruara të partnerëve për të blerë pajisjet e duhura për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. (*Kapitulli III, Standardi VII.5*).

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk bëri asnjë pohim për veprimet tashmë në proces.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1. Akademia ofron një program studimi të ciklit të parë me kohë të plotë në “Film dhe Media”, në katër profile “Regjisurë”, “Skenar”, “Kamera” dhe “Montazh”. Programi përmbush misionin e fondacionit AFMM për të ofruar trajnim profesional, dhe veprimtari krijuese, produktive dhe kërkimore në fushën e Filmit dhe Multimedias [1]. Falë karakterit të tij profesional, programi adreson trajnimin specifik dhe AFMM-ja ka krijuar një profil të vetin me kualifikimet që ai ofron në fushat e regjisurës, skenarit, kameras dhe montazhit që prej 2004 [RVV, 8a-8f].

Objektivat e programit promovohen në faqen e internetit të Akademisë (<https://afmm.edu.al/faculty/program/>). AFMM-ja organizon fushata promovuese në arsimin parauniversitar [E] dhe merr pjesë në panairët e studentëve të organizuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) [36]. Gjithashtu, ajo ndjek një politikë të përcaktuar qartë për pranimin e studentëve nëpërmjet udhëzuesve promovuese [50]. Pranimi i studentëve organizohet nëpërmjet portalit U-Albania, duke përmbushur procedurat e përcaktuara nga MASR-ja. Kandidatët e pranueshëm i nënshtrohen provimit të pranimit nëpërmjet një testi me gojë rreth kulturës së përgjithshme, një testi me shkrim për analizën e veprave të artit dhe një kolazhi fotografik. Kriteret janë bërë publike [4, 36, <https://afmm.edu.al/faculty/admissions>]. Statuti i saj parashikon edhe pranimin e kandidatëve të huaj [1], kryesisht nga Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit. Vlerësimi i studimeve miratohet nga organet kolegjiale, si Drejtori [1, M4] dhe nenet 18, 19, 23, 24 të Rregullores së studimeve përcaktojnë kërkesat e vlerësimit të detyrave teorike dhe punës praktike të kryera nga studentët [4, 43-45, X]. Provimet janë kryesisht me shkrim [AE15]; megjithatë, studentët vlerësohen edhe për procedurat praktike të prodhimit të filmit [43]. Provimi i diplomimit konsiston në një film vjetor në fund të vitit nën regjinë e secilit student sipas profilit të tyre përkatës (skenar, kamera, montazh dhe regjisurë) [42, RVV]. (*Kapitulli I, Standardi I.1*).

Programi i studimit organizohet për t’iu përshtatur sistemit të Bolonjës në tre ciklet akademike, me kohë të plotë, me një shumë minimale kreditesh prej 60 ECTS në vit [1, P]. Struktura e mësimdhënies ka natyrë teorike dhe praktike/profesionale. Kurset organizohen në leksione, masterklasa, workshop-e, seminare dhe punë teknike praktike dhe teorike [P]. **Kontributi i pedagogëve të huaj për të zgjeruar gamën e kualifikimeve të kurrikulës në profilin e programit studimor konsiderohet një shembull i praktikës së mirë [15, M7].** Programi studimor ofron njohuri konsistente përgjatë viteve akademike. Viti i parë ofron njohuritë bazë në kinematografi, që përfshijnë rotacionin e pozicioneve në ekip për çdo student në vitet pasuese [O, RVV]. Komponentë përkatës organizohen sipas një raporti në rritje të ngarkesës së punës në favor të askeutit praktik; ky i fundit zë 50% të kurrikulës së vitit të parë, 60% të vitit të dytë dhe 75% të vitit të tretë [4]. Studentët mund të fitojnë mbi 60 ECTS në secilin vit akademik [37], pasi plani i kurrikulës i shqyrtuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm nuk reflekton asnjë kurs me zgjedhje. Për më tepër, sistemi i kurseve që rindiqen në dy vitet pasuese duhet rishikuar me kujdes nga përgjegjësit e departamenteve të AFMM-së për të shmangur përsëritjen e kurseve në vitet pasuese ose ngarkesën e pamjaftueshme për studentët gjatë secilit vit akademik [M3]. Plani i kurrikulës së tre viteve të njëpasnjëshme duhet të përmbushë kërkesat formuese të kuadrit ligjor në fuqi. Studentët marrin njohuri për profilin në fusha specifike të diplomimit në vitin e tretë, duke prodhuar vetë një film me metrazh të shkurtër, nën udhëheqjen e pedagogëve [5, 30]. Një pjesë e programit ofrohet në gjuhën angleze [15] dhe njohuritë për një gjuhë të huaj

është kërkesa e kriterëve të pranimit të studentëve [1, 15]. Në përputhje me VKM-në, që përcakton statusin e saj të veçantë, AFMM-ja nuk ofron studime të ciklit të dytë ose pas diplomimit. Ajo ofron workshop-e të përvitshme [15, 8e] dhe struktura videokonferencash për kualifikime të të nxëniet gjatë gjithë jetës, të cilat përfshijnë edhe ish studentë [21, 29, 33]. AFMM-ja nxit pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve të saj në aktivitete ndërkombëtare të organizuara nga partnerët e saj, ose në festivale ndërkombëtare [33, 43, 17, 16a-16g]. Anëtarësimi aktiv në CILECT, një shoqatë ndërkombëtare e shkollave të filmit, i mundëson Akademisë komunikimin aktual për botën e prodhimit të filmit [13, 6a-6m, M2, M12]. **(Kapitulli I, Standardi I.2).**

Programet studimore janë planifikuar të përmbushin nenet 3 dhe 5 të Statutit [1]. Oferta akademike integron njohuritë dhe kualifikimin e reflektuar në diplomat e lëshuara me përfundimin e studimeve: “Bachelor” në Film dhe Media, profili “Regjisurë”, “Bachelor” në Film dhe Media, profili “Kamera”, “Bachelor” në Film dhe Media, profili “Skenar”; “Bachelor” në Film dhe Media, profili “Montazh” [1, 37, U]. Akademia ka shkëmbyer korrespondenca me Qendrën e Shërbimeve Arsimore dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, lidhur me miratimin e përditësimeve të bëra në diplomë dhe në formatin e suplementit, për të përmbushur kërkesat e ligjit të ri për arsimin e lartë. Mungesa e feedback-ut ka penguar lëshimin e diplomave për studentët e diplomuar së fundmi. [M9, AE9-AE13]. **(Kapitulli I, Standardi I.3).**

3.4 AFMM-ja pretendon statusin e institucionit të parë të arsimit të lartë profesional në fushën e kinematografisë dhe televizionit në Shqipëri, të krijuar për të përmbushur nevojat për kualifikim në fushën e filmit, multimedias dhe televizionit [1]. Ajo monitoron programet e saj të studimit për të siguruar që të mbeten koherente dhe aktive me nevojat kombëtare. Plani i zhvillimit parashikon programet e reja në Prodhim, Zërin në Film dhe studion e Aktorëve [B], që konfirmohet edhe nga mbledhja me punonjësit dhe alumnin [M7]. Gjatë vizitës, AFMM-ja vuri në dispozicion një dosje aplikimi për një kurrikul të re në “Prodhimin e Filmit” [W], që **grupi i vlerësimit të jashtëm e pohon si nismë të akademisë për të zgjeruar gamën e kualifikimeve për të përmbushur tendencat e reja të tregut të punës.** AFMM-ja nxit pjesëmarrjen e stafit të huaj të ftuar në kualifikimin e studentëve të tij [31-32], si dhe marrëveshjet e stazhit me industrinë e filmit [56, N]. Gjithashtu, ajo shfaq një sërë marrëveshjesh me institucionet e huaja homologe dhe është anëtare me të drejta të plota e CILECT, FIOFA, IFS, IHRFFA [6b-6m]. Gjatë periudhës 2004-2018, Akademia ka pasur edhe studentë të huaj [38]. Studentët nxiten të marrin pjesë në aktivitete ndërkombëtare për të promovuar kualifikimet e Akademisë [16-16f]. Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk vuri re asnjë evidencë të mobilitetit të studentëve aktualë/transferimit të studimeve në institucionet homologe, edhe pse kjo ka ndodhur në të shkuarën, dhe Akademia ka plane që diçka e tillë të ndodhë këtë vit **(referuar pikës 3.7).** **(Kapitulli I, Standardi I.4).**

3.5 Statusi i veçantë i mundëson Akademisë së ketë jo më shumë se 10 studentë për çdo anëtar të stafit akademik me kohë të plotë [3]. Aktualisht, Akademia ka 4 pedagogë me kohë të plotë dhe 12 studentë [38]. Pjesa më e madhe e mësimdhënies zhvillohet nga stafi me kohë të pjesshme, për shkak të profilit profesional specifik të kërkuar [9, 9a-9t]. Kostoja për stafin me kohë të pjesshme mbulohet nga të ardhurat e institucionit që mblidhen nga tarifat studentore

[RVV]. Statusi i veçantë i lejon stafit akademik që përbëhet nga specialistë në fushat audiovizuale të kinematografisë, medias televizive, arteve pamore dhe kulturës [3], të ketë kryesisht ngarkesë mësimore dhe pak kërkim akademik në fushën e tyre përkatëse [RVV, 3]. **(Kapitulli I, Standardi I.5).**

3.6 Përmbajtja e programeve të studimit iu vihet në dispozicion studentëve në faqen e internetit [<https://afmm.edu.al/faculty/program/>] dhe në këndet e informacionit në ambientet e akademisë [M3, M5]. Studentët marrin informacion nga Drejtori Administrativ [M3, M5]. Kriteret e pranimit shfaqen edhe në faqen e internetit [<https://afmm.edu.al/faculty/admissions/>] dhe në broshurat promovuese [36]. Të gjitha të mësipërmet reflektohen në Rregulloren e studimeve [4]. **(Kapitulli I, Standardi I.6).**

3.7 AFMM-ja ofron vetëm një program të ciklit të parë. Diploma e dhënë mundëson përparimin në studimet master në institucionet homologe [3]. Programi aktual i ofruar iu mundëson studentëve njohuri bazë gjatë vitit të parë, pavarësisht profilit të zgjedhur gjatë viteve pasuese. Përzgjedhja e profileve dhe përcaktimi i ekipeve me rotacion bëhet nga Këshilli Akademik në fillim të vitit të dytë, ndërsa në vitin e tretë parashikohet xhirimi i filmave dhe puna në ekip për çdo student [G, 42-44]. Gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm, studentët pohuan se organet vendimmarrëse duhet të marrin parasysh edhe pikëpamjet e studentëve lidhur me profilin e studimeve në vitin e dytë dhe të tretë të programit, edhe pse Qendra i ka procedurat që diçka e tillë të ndodhë. [M3]. Programi i studimit planifikohet të ofrojë mundësi punësimi në fushat e kinematografisë, ekipet e xhimit të filmave dhe dokumentarëve pas diplomimit [37, 12]. AFMM-ja ofron mundësi për transferimin e studimeve dhe ekuivalentimin e tyre. Rregullorja e studimeve mundëson procedurat e transferimit të studimeve në dhe jashtë Akademisë, të cilat zhvillohen në përputhje me aktet e transferimit me institucionet e tjera; transfertat në Akademi pranohen pas miratimit nga Komisioni i Përkohshëm i Pranimit të Transferimeve [1, 4]. Megjithatë, grupi i vlerësimit të jashtëm nuk u njoh me asnjë evidencë të procedurave të transferimit të studimeve. [AE1]. **(Kapitulli I, Standardi I.7).**

3.8 Programet e studimit ofrohen sipas një larmie metodash të mësimdhënies, si teorike edhe praktike. Në mbledhjet me stafin akademik, përgjegjësit e departamenteve dhe stafin mbështetës u theksua përpjekja e Akademisë për të mbështetur përshtatjen e studentëve, për shkak të madhësisë modeste të institucionit dhe numrit të kufizuar të studentëve dhe stafit [M4, M9, M5]. Studentët pohojnë se edhe pse zyra e administratorit është e disponueshme për asistencë, ata do të dëshironin t'ju viheshin në dispozicion më shumë shërbimeve këshilluese, informuese dhe mbështetëse [M3]. **(Kapitulli I, Standardi I.8).**

3.9 Akademia nuk ofron asnjë program studimor të ciklit të dytë, dhe as nuk parashikon që diçka e tillë të ndodhë në të ardhmen, për shkak të statusit të saj të veçantë [3]. Duke marrë parasysh nevojat e tregut të punës për programe të reja, Akademia pohon se hapja e një programi studimor të ciklit të dytë në profilet që ofron AFMM-ja do të ishte e papërshtatshme për një treg që nuk ka nevojë për kërkim profesional të këtij lloji [M13]. Plani i zhvillimit parashikon pranime të vazhdueshme në shkollat ndërkombëtare perëndimore për studime pas diplomimi të

studentëve të AFMM-së në specializim Master, si një strategjia e zhvillimit afatshkurtër **[B]**. **(Kapitulli I, Standardi I.9).**

3.10 Kurrikula organizohet në 180 ECTS në përputhje me procesin e Bolonjës, dhe dhënia e diplomës shoqërohet me suplementin e saj **[4, 37]**. Studentët nxiten të zotërojnë njohuri të gjuhës angleze **[1]**. AFMM-ja paraqet një kuadër të krijuar ligjor për transferimin e studimeve dhe mobilitetin e studentëve **[4]**, por grupi i vlerësimit të jashtëm nuk u njoh me asnjë rast të mobilitetit aktual **[1AE]**. **(Kapitulli I, Standardi I.10).**

3.11 - 3.12 Programi organizohet në mënyrë të tillë që fillimisht të prezantohen njohuritë teorike, dhe më pas të zhvillohen aftësitë zbatuese në praktikë gjatë vitit të dytë dhe të tretë. Nenet 6 dhe 10 të Rregullores së Studimeve përcaktojnë raportin e kurseve teorike, praktike dhe të prodhimit artistik **[3]**. Profilet studimore reflektohen në kurse specifike të vitit të parë dhe të dytë **[O, X]**. Gjatë studimeve të tyre, studentët përgatisin filma, dokumentarë dhe shfaqje **[M7, RVV]**. Edhe provimi i diplomimit konsiston në prodhimin e një filmi. AFMM-ja ndjek politikat mbështetëse për pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari kulturore dhe arsimor **[28, 16a-16f]**. **Pjesëmarrja në workshop-e profesionale, promovimi i punës së studentëve në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare të filmit, dhe periudhat e stazhit në institucione vendase të filmit mundësojnë kalimin e lehtë të të diplomuarve në tregun e punës (referuar pikës 1.9, 2.4, 5.10).** Kjo konsiderohet shembull i **praktikës së mirë**, që mundëson zbatimin në praktikë të njohurive dhe aftësive, i afron studentët me tregun e punës, rrit përfshirjen e AFMM-së në veprimtari sociale dhe promovon punën e studentëve në kontekstin vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar. **(Kapitulli I, Standardi I.11), (Kapitulli I, Standardi I.12).**

3.13 AFMM-ja është një institucion i arsimit të lartë që ofron kualifikime të specializuara në kontekstin e filmit dhe multimedias në Shqipëri, në përputhje me misionin dhe kapacitetet e saj. Statusi i Veçantë i dhënë nga MASR-ja e lejon institucionin t'i përshtatë kapacitetet e tij modeste të stafit dhe studentëve me nevojat e tregut të punës. Gjatë viteve të fundit ka pasur një ulje të numrit të regjistrimeve, ndërsa AFMM-ja parashikon fonde për të mbështetur këtë humbje të të ardhurave. Ajo ofron vetëm programe studimi të ciklit të parë, në përputhje me misionin e saj, tendencat kombëtar, dhe specifikimet e statusit të veçantë. Ngarkesa e programit shpërndahet sipas një kalimi progresiv, nga veprimtari të teorike tek ato praktike, dhe studentët nxiten të marrin pjesë në një numër të konsiderueshëm veprimtarish profesionale kurrikulare dhe jashtëkurrikulare, të cilat iu mundësojnë të diplomuarve akses në tregun e punës.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Kontributin e pedagogëve të jashtëm për të zgjeruar gamën e kualifikimeve të kurrikulës në profilin e programit studimor. (Kapitulli I, Standardi I.2 Kapitulli I, Standardi I.4)

- Pjesëmarrja në workshop-e profesionale, promovimi i punës së studentëve në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare të filmit, dhe periudhat e stazhit në institucione vendase të filmit mundësojnë kalimin e lehtë të të diplomuarve në tregun e punës. (Kapitulli I, Standardi I.4, Kapitulli I, Standardi I.11, Kapitulli I, Standardi I.12, Kapitulli I, Standardi III.8)

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm pohoi veprimin e mëposhtëm në proces:

- Nisma e Akademisë të zgjerojë gamën e kualifikimeve të ofruara për të përmbushur tendencat e reja në tregun e punës. (*Kapitulli I, Standardi I.4*)

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 Programet e studimit ofrojnë kapacitete të mjaftueshme për qasjet praktike [D]. Orët mësimore përfshijnë edhe masterklasa, workshop-e, seminare dhe punë praktike [4]. Njësia e Prodhimit mbikëqyr punën laboratorike dhe orët mësimore praktike. Ajo është përgjegjëse për organizimin e të gjitha produksioneve, post-produksioneve dhe shpërndarjen e filmave të studentëve, lidhur me përmbledhjen, trajtimin artistik, shprehjen e qëllimit dhe skenarin [4, 41, M9]. Neni 14 i Rregullores së studimeve përcakton ngarkesën praktike të studentëve në prodhimin e filmave me metrazh të shkurtër gjatë tre viteve të studimit [4]. Edhe teza e diplomimit konsiston në prodhimin e një filmi, në të cilin çdo student është përgjegjës për profilin e vet të studimeve të vitit të dytë dhe të tretë [42-45]. AFMM-ja promovon punët e studentëve, nëpërmjet modeleve me të drejtat e autorit në festivale ndërkombëtare, dhe shfaqjet shihen nga alumni si një reflektim mbi qasjet praktike të kurrikulës [M7, M4]. AFMM-ja ofron një larmi dokumentacioni mbi pjesëmarrjen e studentëve në festivalet e filmit [J, N, 56]. Megjithatë, studentët aktuale nuk kanë shumë informacion për menaxhimin, tutorimin dhe rolin e një stazhieri [M3]. Puna kërkimore e studentëve konsiston në përgatitjen e provimit të diplomimit [RVV]. Evidencat e njoftimeve të dërguara studentëve për aktivitete ndërkombëtare që kanë lidhje me kërkimin nuk tregojnë asnjë dokument të paraqitur [48]. Literatura është e disponueshme në bibliotekë, në format të shtypur, online dhe në arkiv DVD-je [K]. Biblioteka mundëson edhe një abonim në Bookpedia dhe DVDPedia [24, tur]. Megjithatë, studentët e intervistuar nuk kanë dijeni për asnjërën prej tyre [M3]. Programi i studimit vë në dispozicion pajisjet profesionale për orë praktike. Grupi vlerësimit të jashtë vizitoi një sërë laboratorësh dhe sallash për ruajtjen e pajisjeve, të cilat janë të përshtatshme për programin e ofruar [tur, 25], (referuar pikës 2.8). (Kapitulli I, Standardi II,1).

4.2 Rregullat e provimit, si edhe kërkesat e vlerësimit, miratohen në Rregulloren e studimeve. Ajo paraqet edhe detaje për frekuentimin, vlerësimin e vazhdueshëm, përsëritjen e vitit, dhënien e provimit për herë të dytë, dhe rastet e përjashtimit [4]. Studentët janë në dijeni për procedurat e vlerësimit dhe kërkesat e diplomimit [M3]. Ekziston një sistem online i informimit, dhe Drejtori Administrativ regjistron të gjithë dokumentacionin në format të shtypur në dosje. Studentët mund të kenë akses në të në çdo moment, me kërkesë pranë Drejtorit Administrativ [M3, M5, 23, 29, tur]. Originalët e formularëve të plotësuar nga profesionistët me vlerësimin përkatës gjatë analizës së filmit mbahen në një dosje të veçantë dhe regjistrohen në një tryezë elektronike [RVV]. Procedurat për ankimmimet parashikohen në Rregulloren e studimeve [4], por nuk ka asnjë evidencë për raste të tilla [1AE]. (Kapitulli I, Standardi II,2).

4.3 Ndryshimet në kurrikul bëhen për të rritur gamën e kualifikimeve profesionale [47, 8a-8f]. Studentët përfshihen në vlerësimin e leksionit nëpërmjet pyetësorëve. Pjesëmarrja e studentëve është anonime [RVV, 46]. Në intervistat gjatë vizitës, as studentët dhe as përfaqësuesit e Këshillit Studentor nuk zbuluan raste të feedback-ut të ofruar për ta përmes pyetësorëve, ose se kanë qenë të përfshirë në diskutimin për rishikimin e kurrikulës [M3], çka grupi i vlerësimit të jashtëm e konsideron mungesë të koordinimit të sigurimit të cilësisë. Punonjësit pohojnë se kanë zhvilluar vetëm një diskutim joformal me Drejtorin për rishikimin e kurrikulës [M7], por nuk janë paraqitur evidenca për asnjë procedurë zyrtare. (referuar pikave 1.2, 1.3). Cilësia e

programeve të studimit matet kryesisht përmes përqindjeve të larta të punësimit të të diplomuarve **[M2, 39]. (Kapitulli I, Standardi II,3).**

4.4 Akademia nuk ofron një strukturë që promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Në kohën e vizitës, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ishte një komision i posaçëm, anëtarët e të cilit ishin Drejtori, Drejtori Administrativ dhe Përgjegjësi i Njesisë së Prodhimit. Në të mungon përfaqësimi i studentëve **[M10]**. Rregullorja e Studimeve 2019-2020 pasqyron përmirësimin e strukturës së kësaj njësie me një përfaqësues të studentëve, Përgjegjësin e Këshillit Akademik dhe përgjegjësit e departamenteve **[1AE]**. Megjithatë, grupi i vlerësimit të jashtëm gjykon se Akademia duhet të jetë më e informuar për politikat sistematike të sigurimit të brendshëm të cilësisë, dhe të prezantojë mekanizmat e qëndrueshëm të matjes së cilësisë së mësimdhënies, performancës së studentëve, dhe strukturat e disponueshme për të dyja **(referuar pikave 1.2, 1.3). [(Kapitulli I, Standardi II,3).**

4.5 Statusi i veçantë i jep Akademisë të drejtën për veprimtari akademike specifike të lidhura ngushtësisht me organizimin dhe zhvillimin e mësimdhënies **[2]**. Stafi menaxherial **[M12]** dhe akademik **[M4]** pohon se profili profesional specifik i Akademisë nuk kërkon kërkimin e duhur akademik. Ai përfshin kryesisht nxitjen e studentëve për të kërkuar dhe gjetur zgjidhje novatore, krijuese dhe teknike për realizimin e projekteve të tyre filmike për diplomim **[RVV]**, duke bërë njoftime përmes email-it për pjesëmarrje në konferenca **[48]** dhe publikimin e teksteve shkollorë të kursit **[M9]**. Raporti i vetëvlerësimit, dosja e vetëvlerësimit dhe shpjegimi i dhënë nga grupi i vlerësimit të jashtëm **[1AE]** nuk ofrojnë asnjë publikim dokumentesh ose pjesëmarrje në projekte kërkimore. Për këtë arsye, nuk është e mundur të bëhet një gjykim për kërkimin, dhe grupi i vlerësimit të jashtëm mendon se nuk mund të nxjerrë asnjë përfundim për standardet e paraqitura në Kapitullin II, Standardin I.1, Kapitullin II, Standardin I.2, Kapitullin II, Standardin I.3, Kapitullin II, Standardin I.4, Kapitullin II, Standardin I.5, Kapitullin II, Standardin I.6, Kapitullin II, Standardin I.7, Kapitullin II, Standardin I.8. **(Kapitulli II, Standardi I.1, Kapitulli II, Standardi I.2, Kapitulli II, Standardi I.3, Kapitulli II, Standardi I.4, Kapitulli II, Standardi I.5, Kapitulli II, Standardi I.6, Kapitulli II, Standardi I.7, Kapitulli II, Standardi I.8).**

4.6 AFMM-ja ka një profil shumë profesional në mësimdhënien, mësimnxënien dhe vlerësimin e saj. Në Rregulloren e vetë të studimeve, ajo përcakton përgjegjësitë e duhura për menaxhimin e tyre. Programet e studimit zbatohen në rrethanat e duhura dhe njoftohen në mënyrë efikase. AFMM-ja ofron pajisje profesionale dhe laboratorë për procesin e mësimdhënies. Rregullat e provimit dhe kërkesat e vlerësimit miratohen nga organet vendimmarrëse. Studentët kanë dijeni për kriteret e vlerësimit dhe mund të kenë akses në informacion për vlerësimin e tyre në zyrën e Drejtorit Administrativ. Në këtë të fundit ruhen dosjet në format të shtypur të studentëve dhe stafit. Ka një mungesë të strukturës për njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë për të monitoruar zbatimin cilësor të programeve të studimit dhe për t'i përfshirë studentët në çështje të rishikimit të kurrikulës ose cilësisë së mësimdhënies. Ajo duhet të krijojë një qasje sistematike dhe të prezantojë mekanizmat e qëndrueshëm të matjes për fushat e cilësisë së mësimdhënies së stafit, performancën e studentëve dhe strukturat e disponueshme për të dyja. Megjithëse “statusi i veçantë” e liron atë nga detyrimet e kërkimit të duhur akademik, grupi i vlerësimit të

jashtëm përfundon se mund ta përdorë në të ardhmen si një mjet mbështetës për përditësimin e kualifikimeve profesionale që ajo ofron.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë praktikë të mirë.

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimeve të ndërmarra.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 AFMM-ja promovon programet e saj të studimit në institucionet parauniversitare [RVV]. Drejtori Administrativ ofron informacion për kandidatët [M5], duke marrë pjesë në panairët e institucioneve të arsimit të lartë të organizuara nga Drejtoria Arsimore Rajonale [E]. Akademia mirëpret studentët e huaj folës të gjuhës shqipe të interesuar për ndjekjen e studimeve [1, 38]. Aktualisht, asnjë student i huaj nuk ndjek studimet në Akademi [8f]. Plani i Zhvillimit propozon zgjerimin e programeve shumëgjuhëshe në gjuhën shqipe, angleze, franceze dhe italiane, dhe mundësinë për të shpërndarë diploma të përbashkëta me shkolla homologe në Evropë, si objektivi afatmesëm [B]. Studentët pranohen nëpërmjet një provimi pranimit, kriteret, afatet dhe procedurat e të cilit parashikohen në nenet 25 dhe 26 të Statutit [1]. Ato shfaqen në faqen e internetit (<https://afmm.edu.al/faculty/admissions/>), si dhe në materiale promocionale [36]. Plani i Zhvillimit përmban vetëm objektiva afatgjata për pranimin e më shumë studentëve nga Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit, dhe ka disa projekte zhvillimore për të rritur përqindjet e regjistrimit të studentëve shqiptarë [B]. Për shkak të numrit shumë të vogël të regjistrimeve, Akademia nuk ka një zyrë pranimit dhe detyrat e saj ushtrohen nga Drejtori Administrativ [M3, M5]. *(Kapitulli I, Standardi III, 1).*

5.2 Komunikimi me studentët dhe stafin akademik menaxhohet nga zyra e Drejtorit Administrativ [49]. Ajo ruan kopjet në format të shtypur të dosjeve të studentëve [tur, 23]. Gjithashtu, ajo menaxhon informacionin këshillues, procedurat e vlerësimit, promovimet e aktiviteteve, materialet e programit studimor dhe përdorimin e bibliotekës [tur] [1, M3, M5]. Për të gjitha të mësipërmet, Akademia përdor faqen e vet të internetit, llogarinë në Facebook, Instagram dhe kanalin YouTube për komunikimet e jashtme me partnerët [RVV]. Komunikimi i brendshëm menaxhohet nëpërmjet një rrjeti të email-eve institucionale (@afmm.edu.al), SMS-ve dhe grupeve në WhatsApp, që përdoren edhe për të promovuar aktivitetet e AFMM-së [50]. Administrata mban edhe regjistra me informacionet e kontaktit të studentëve [49]. *(Kapitulli I, Standardi III, 2).*

5.3 Shërbimet udhëzuese, këshilluese dhe orientuese të studentëve ofrohen që të gjitha nga zyra e Drejtorit Administrativ dhe Përgjegjësit të Prodhimeve [M3, M7]. Statuti parashikon raste të transferimit të studimeve [1]; megjithatë, nuk janë shënuar raste të çregjistrimit. Akademia i mbështet studentët e saj të ndjekin më tej ciklin e dytë të studimeve në institucione homologe të rrjetit CILECT [51, 33]. *(Kapitulli I, Standardi III, 3).*

5.4 AFMM-ja nuk ka pasur asnjë kërkesë nga studentët nga kategori sociale të veçanta; dhe as nuk ofron studime me kohë të pjesshme [RVV]. Me dhënien e statusit të veçantë nga qeveria (Vendimi Nr. 571, datë 08.08.2019), Akademia ka përgjysmuar tarifat studentore për të rritur dhe mbështetur krijimtarinë e tyre [53]. *(Kapitulli I, Standardi III, 4).*

5.5 Stafi akademik ofron tekste shkollorë për të mbështetur kurset teorike [M3, M9]. Programet mësimore ofrojnë informacion mbi literaturën për konsultim [35]. Në ambientet e AFMM-së ndodhet një bibliotekë [tur], e cila i ruan filmat në formate DVD, VHS, libra, duke përfshirë specialitetet e kinemasë, enciklopeditë dhe titujt e videove [K]. Biblioteka menaxhohet nga

Drejtori Administrativ, me kërkesë të studentëve. Nuk ka kartela regjistrimi për studentët, dhe huatë regjistrohen manualisht [RVV]. BookPedia dhe DVDPedia ofrojnë materiale shtesë shumëdisiplinore të disponueshme për studentët [24]. Megjithatë, studentët kanë shumë pak informacion për mundësitë e aksesit në secilën prej tyre, pavarësisht se Akademia i ka vënë në dispozicion [M3]. *(Kapitulli I, Standardi III, 5).*

5.6 Raporti i ulët ndërmjet stafit akademik dhe studentëve, për shembull 4 pedagogë me kohë të plotë për dymbëdhjetë studentë në vitin akademik 2018-2019 [38, 9q], i mundëson Akademisë të ofrojë këshillim dhe tutorim për studentë individualë në klasat e tyre, kryesisht lidhur me çështje të filmave me metrazh të shkurtër dhe shfaqjes së tyre [RVV, M4]. Studentët pohojnë se disa nga mësuesit i ndihmojnë me procedurat e tyre të orientimit kurrikular në veprimtaritë në klasë; megjithatë, ata sugjerojnë me vendosmëri se stafi duhet të ofrojë më shumë asistencë këshilluese dhe feedback pozitiv për sa u përket zërit të studentëve në frekuentimin e kursit, profilin e studiuar dhe përditësimet e pajisjeve [M3]. *(Kapitulli I, Standardi III, 6).*

5.7 Statusi i AFMM-së e parashikon Këshillin Studentor si pjesë të strukturës së vet organizative. Ai përbëhet nga të paktën 3 anëtarë të zgjedhur çdo vit nga studentët [1]. Kryetari i Këshillit Studentor është anëtar i përhershëm i Komisionit të Etikës dhe Disiplinës [RVV]. Veprimtaritë e Këshillit Studentor kufizohen kryesisht në aktivitete jashtëkurrikulare dhe bamirëse [M3]. Pavarësisht kuadrit ligjor, **ka evidenca të pakta për përfshirjen e Këshillit Studentor në procedurat vendimmarrëse ose në zbatimin e kurrikulës**, çka grupi i vlerësimit të jashtëm e konsideron **dobësi** [M3]. **Ai i rekomandon Akademisë të promovojë pjesëmarrjen më aktive të përfaqësuesve të studentëve në çështjet e saj organizative, dhe të ofrojë feedback real për nevojat e studentëve.** Kjo do të rriste vetëbesimin e studentëve dhe ndërgjegjësimin e tyre për përmirësimin e cilësisë së AFMM-së. *(Kapitulli I, Standardi III, 7).*

5.8 Profili profesional i AFMM-së i mundëson asaj të zgjerojë fushëveprimin e veprimtarive praktike të kurrikulës [5] në një kontekst më të gjerë [8f]. Ai i angazhon studentët në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare të filmit [16a-16g], organizon workshop-e për tema profesionale [31, 32, 33], ofron akses aktiv në CILECT [6a] dhe ndihmon në pjesëmarrjen aktive në tregun e punës dhe veprimtaritë komunitare, si shfaqjet [M3, J]. Kjo mbështet shembullin e **praktikës së mirë** në pikat 3.11 dhe 3.12 të këtij raporti. Aktivitetet kulturore pasuese njoftohen nga Drejtori Administrativ [49]. Akademia i pajis studentët me sigurimet shëndetësore [RVV, M5]. Në ambientet e AFMM-së garantohet shëndeti dhe siguria e pajisjeve dhe laboratorëve [tur]. *(Kapitulli I, Standardi III, 8).*

5.9 AFMM-ja mban statistika për punësimin e të diplomuarve të saj [39]. Përqindjet e larta të punësueshmërisë në profilet lidhur me filmin dhe median janë të dukshme [12, 39] dhe konfirmohen edhe nga alumni dhe palët e tjera të interesit [M7]. AFMM-ja ofron asistencë për integrimin e të diplomuarve në tregun e punës [51, M7]. Gjithashtu, ajo ruan komunikimin me alumnin lidhur me organizimin e aktiviteteve dhe promovimin e nevojave të tregut të punës [H]. Në të ardhmen e afërt, Akademia synon të krijojë një sistem integral alumni online [M5], çka ka

qenë një objektiv i AFMM-së që prej vlerësimit të saj të fundit për akreditimin. Duke pasur parasysh progresin e ngadaltë në këtë aspekt, grupi i vlerësimit të jashtëm e nxit AFMM-në që të krijojë një sistem më efikas të komunikimit me alumnin e vet, jo vetëm lidhur me punësueshmërinë, por edhe me përmirësimin dhe promovimin e kurrikulës, dhe përditësimet e kurrikulës. **(Kapitulli I, Standardi III, 9).**

5.10 AFMM-ja ndjek politikat e duhura për pranimin e studentëve të saj, i promovon ato kryesisht në nivel kombëtar, dhe synon të rrisë përqindjen e regjistrimit të studentëve joshqiptarë. Gjithashtu, ajo ka një sistem shumë të mirë të politikave mbështetëse për të siguruar përfshirjen kulturore të studentëve të saj në profilin profesional të industrisë së filmit dhe medias. Grupi i vlerësimit të jashtëm e konsideron atë një shembull të praktikës së mirë në mbështetje të gjetjeve të pikave 3.11-3.12. Drejtori Administrativ ruan komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm kryesisht nëpërmjet rrjeteve sociale. Ai regjistron përqindjet e punësueshmërisë dhe promovon aktivitetet sociale dhe kurrikulare si për studentët edhe për alumnin. Shumica e politikave këshillimore, këshilluese dhe udhëzuese zhvillohen nga kjo zyrë, e ndihmuar nga stafi akademik me kohë të plotë. Studentët pohojnë se ata do të dëshironin një qasje më të kujdesshme nga Akademia për nevojat e tyre të orientimit kurrikular, dhe tregojnë se kanë pak informacion lidhur me dobishmërinë e burimeve të bibliotekës. Megjithëse Akademia ka një Këshill Studentor dhe e mbështet atë me një kuadër ligjor **[1]**, dhe ky i fundit nuk është shumë aktiv në rolin e tij ndërmjetësues ndërmjet organeve vendimmarrëse dhe studentëve, çka grupi i vlerësimit të jashtëm e konsideron dobësi. Akademia duhet të promovojë pjesëmarrje më aktive të përfaqësuesve të studentëve në çështjet e saj organizative, dhe rrjedhimisht të ofrojë feedback real për nevojat e studentëve. **(Kapitulli I, Standardi III, 8).**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- Ka evidenca të pakta të përfshirjes aktive të Këshillit Studentor në procedurat vendimmarrëse ose në zbatimin e kurrikulës. **(Kapitulli I, Standardi III, 7).**

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Akademia duhet të promovojë pjesëmarrjen më aktive të përfaqësuesve të studentëve në çështjet e saj organizative dhe duhet të ofrojë feedback të vërtetë për nevojat e nxënësve.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

Lista e evidencave

Dokumentet në këtë listë u dorëzuan nga universiteti për të shoqëruar raportin e vetëvlerësimit dhe paraqiten në faqen e menaxhimit të ASCAL-it nën titullin faza e vetëvlerësimit e procesit.

Të ngarkuara me RVV-në

- RVV. Raporti i-Vetëvlerësimit-Institucional-AFMM2019_nënshkruar_2_1.
1. Statutet e AFMM-së 2018_MASR.
 2. Urdhër i MASR-së për miratimin e Statuteve nr. 494, datë 30.07.2018.
 3. Statusi i Veçantë_VKM Nr. 229, datë 26.04.2018.
 4. Rregulloret_Tetor 2018.
 5. vademecum AFMM 2016_2017 anglisht.
 - 6a. Anëtarët me të drejta të plota të CILECT.
 - 6b. FIOFA_AFMM_MM_20170505.
 - 6c. Marrëveshje me Parlamentin-AFMM 31 tetor 2018.
 - 6d. Marrëveshje Partneriteti me fondacionin MAM
 - 6e. MM rinovim IFS_2014
 - 6f. MM Shkolla Don Bosko 2019
 - 6g. MM_Stavrakos-Marubi2019.
 - 6h. Thirrje e hapur për Kampin e Filmit Dokumentar 2019 SHQ:ANG
 - 6i. Marrëveshje Bashkëpunimi_IHRFFA Shqipëri_190108
 - 6j. Të trajtojmë të shkuarën_kontratë me qeverinë zvicerane.
 - 6k. Festivali i Bashkëpunimit GoEast_2016
 - 6l. MB për Projektin e Kinemasë Shqiptare_2016.
 - 6m. MM bashkëpunim me Arkivin Shtetëror të Filmit.
 7. VKM nr. 65, datë 03022017_SHQ:ANG.
 - 8a. Raportet Vjetore 2012-2013_FINAL.
 - 8b. Raportet Vjetore 2013-2014_FINAL.
 - 8c. Raportet Vjetore 2014+15 FINAL.
 - 8d. Raportet Vjetore 2015-16_final.
 - 8e. Raportet Vjetore 2016-17_final.
 - 8f. Raporti Vjetor 2017-2018.
 9. Marrëveshje ndërmjet MASR-AFMM Personeli Akademik tetor 2018.
 - 9a. Piro Milkani - Biografi e shkurtër
 - 9b. Timo Filloko - Biografi e shkurtër

- 9c. Biografi Luljeta LLESHANAKU.
- 9d. CV Alfred Diebold.
- 9e. CV Arben Lami.
- 9f. CV Arianit Gjonbalaj.
- 9g. CV Bruce Williams.
- 9h. CV Eol Çashku.
- 9i. CV Eno Milkani.
- 9j. CV Kujtim Cashku 2019_ENG.
- 9k. CV Orafilm_ENG.
- 9l. CV Vladimir Prifti.
- 9m. CV Zef Paci.
- 9n. Lista e Pedagogëve 2015-2016.
- 9o. Lista e Pedagogëve 2016-2017.
- 9p. Lista e pedagogëve 2017-2018.
- 9q. Lista e pedagogëve 2018-2019.
- 9r. Lista e Pedagogëve të ftuar 2016-2017.
- 9s. CV Eduart Makri.
- 9t. CV Majlinda Tafa_alb.
- 11. Shembuj të Vendimit të Këshillit Akademik
- 12. Informacion mbi punësimin aktual të ish studentëve
- 13. Konferencë GEECT-CILECT 2011-2018_Prova pjesëmarrjeje
- 14. Prodhime ndërkombëtare të filmave
- 15. Programe të zhvilluara nga pedagogë të huaj
- 16a. Filmat e studentëve të AFMM_ Çmimet 2018.
- 16b. Festivali Artinvita në Itali 2019.
- 16c. Konkursi Kombëtar i Festivalit të Filmit Dokumentar 2018_Adem Reka
- 16d. Konkursi Kombëtar i Festivalit të Filmit Dokumentar 2018_Verbally Correct
- 16e. Pjesëmarrje në Festalet Marubi 2008-2018 me tituj
- 16f. Pjesëmarrje e suksesshme në Festivalin e 10-të të Filmit me Metrazh të Shkurtër BBB në Athinë 2019.
- 16g. OSKAR_Çmimet e Akademisë së Studentëve_Irdit Kaso_2016.
- 17. GEECT-Raport për-mësimdhënien mbi-dokumentarin.
- 18. Formate kontratash në gjuhën angleze
- 19. Shpërndarja e buxhetit
- 20. Kompjuterat në AFMM 2019
- 21. Videokonferencë me David Lynch 2014_2
- 22. Certifikatë Akt Teknik MZSH 2018.
- 23. Dosjet e studentëve 2004-2018.
- 24. Fotografi e BookPedia
- 24. Fotografi e DVDPedia
- 25. Lista e pajisjeve 2019
- 26. Planimetria e jashtme dhe e brendshme
- 27. AFMM-ja para dhe pas
- 28. Aktivitete 2004-2019
- 29. Regjistrat dhe dokumentacioni i arkivuar
- 30. Përshkrimi i programit mësimor
- 31. Raporte mbi workshopet
- 32. Masterklasa dhe workshope_2014-2019.
- 33. Shembuj informacioni mbi workshopet e specializimeve, etj.
- 34. Vendimi Zyrtar mbi Grantin 2019
- 35. Ekstrakte të programit mësimor në gjuhën angleze

36. Udhëzuesi për aplikim në konkurs 2019.
37. Format diplome së bashku me suplementin dhe notat
38. Statistikat për numrin e studentëve 2004-2018
39. Punësimi i studentëve
40. Miratimi i shkollës verore
41. Shembull i regjistrit të klasës për lëndën e zhvilluar në gjuhën angleze
42. Vendim i komisionit të vlerësimit të tezës së diplomës 2018
43. Shembull i fletës së vlerësimit të filmave 2019
44. Sinteza e vlerësimeve në fund të vitit V3-1819
45. Shembull i provimit me shkrim së bashku me vlerësimin e pedagogut
46. Pyetësorë nga viti 2008 në 2019
47. Krahasime të lëndëve gjatë viteve
48. Njoftime për konferenca ndërkombëtare
49. Grupet e emaileve të studentëve
50. Ekstrakt i buletinit informativ elektronik
51. Letra mbështetjeje për studentët
52. Ekstrakt i kontratës për bursë
53. Evoluimi i tarifave të studentëve
54. Vendimi i zgjedhjes së studentëve 2018
55. Kërkesa nga studentët
56. Marrëveshje stazhi dhe vlerësim 2017.
57. Plan Biznesi 5-vjeçar
58. Letër nga shkolla e filmave CILECT për Qeverinë e Shqipërisë (2009)
59. Artikull në "Variety" 2009

Evidenca shtesë

- A. Organigramat e AFMM-së
- B. Strategjia e Zhvillimit
- C. IHRFFA14_Procesverbali i mbledhjes 1
- D. Raport për kapacitetin pritës nga MAS 2019
- E. Fotografi nga mbledhjet në shkollat e mesme
- F. Plani i kurrikulës
- G. Vendim i Këshillit Akademik
- H. Shembuj të komunikimit me ish studentët
- I. Shembuj të provimeve për lëndë të ndryshme
- J. AFMM Aktivitete 2016-2019
- K. Baza e të dhënave e bibliotekës së librave dhe filmave
- L. Vendim për përjashtim
- M. 20191004 IHRFFA- Marubi_Robert Wilton.
- N. Stazhe_listë joshteruese 2007-2018.
- O. Shembull i kurrikulës për 3 vjet
- P. Kurrikula sipas aktiviteteve formuese
- Q. AFFM_Biblioteka
- R. Letër për MASR-në për ndryshim e ligjore në formën e suplementit të diplomës
- S. Vendim i Këshillit Akademik për formën e diplomës 2018
- T. Kërkesë për regjistrimin e formatit të diplomës 2018
- U. Specimen i diplomës 2018
- V. Urdhër i MASR-së për regjistrimin e formatit të diplomës
- W. Draft projekte për departamente të reja
- X. Shembull i provimeve përfundimtare me shkrim për 2 dhe 3 vjet

Evidenca shitesë të paraqitura në listën e vlerësimit

- AE1. Shkresë Dokumentacion shitesë, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE2. Aneks/Shtojcë Pjesëmarrësit në mbledhje 2019 INST, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE3. Aneks/Shtojcë IHRFFA-Marubi, Robert Wilton, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE4. Aneks/Shtojcë Listë joshteruese e shtazheve 2007-2018, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE5. Aneks/Shtojcë Shembull i kurrikulës për 3 vjet (anglisht), Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE6. Aneks/Shtojcë Shembull i kurrikulës për 3 vjet (shqip), Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE7. Aneks/Shtojcë Kurrikula sipas aktiviteteve formuese (Shqip), Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE8. Aneks/Shtojcë Biblioteka e AFMM-së, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE9. Aneks/Shtojcë Letër për MASR-në për ndryshime ligjore në formën e suplementit të diplomës (shqip), Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE10. Aneks/Shtojcë Vendim i Këshillit Akademik për formën e diplomës 2018 (shqip), Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE11. Aneks/Shtojcë Kërkesë për regjistrimin e formës së diplomës 2018 (shqip), Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE12. Aneks/Shtojcë Specimen i Diplomës 2018, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE13. Aneks/Shtojcë Urdhër i MASR-së për regjistrimin e formës së diplomës 2010 (shqip), Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE14. Aneks/Shtojcë Draft projekte për departamente të reja, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.
- AE15. Aneks/Shtojcë Shembull i provimeve përfundimtare me shkrim për 2 dhe 3 vjet, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi.

Mbledhjet e zhvilluara gjatë vizitës

Mbledhjet janë referuar përgjatë raportit duke përdorur shkurtimet e mëposhtme:

Dita 1 E martë, 8 tetor 2019

- | | |
|---------------|--|
| 09:15 – 09:30 | Mbledhja 1 (M1): Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Koordinatorin Institucional |
| 09:30 - 10:00 | Mbledhja 2 (M2): Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Drejtorin |
| 10:30 - 11:30 | Mbledhja 3 (M3): Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup studentësh të ciklit të parë |
| 13:00 - 14:00 | Mbledhja 4 (M4): Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup të stafit akademik. |
| 14:30 - 15:30 | Mbledhja 5 (M5): Grupi i vlerësimit të jashtëm takon një grup të stafit mbështetës. |
| 16:00 – 17:00 | Mbledhja 6 (M6): Tur në objekte |
| 17:30 – 18:30 | Mbledhja 7 (M7): Grupi i vlerësimit të jashtëm takon punonjës dhe alumnin |

Dita 2 E mërkurë, 9 tetor 2019

09:15 – 09:30 Mbledhja 8 (M8): Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Koordinatorin Institucional

09:30 – 10:30 Mbledhja 9 (M9): Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Përgjegësit e Departamenteve

10:45 – 11:15 Mbledhja 10 (M10): Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Njësinë e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë.

11:30 – 12:30 Mbledhja 12 (M12): Grupi i vlerësimit të jashtëm takon drejtuesit e lartë.

13:15 – 13:45 Mbledhja 13 (M13): Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Grupin e Vetëvlerësimit

14:00 – 14:15 Mbledhja 14 (M14): Grupi i vlerësimit të jashtëm takon Koordinatorin Institucional

14:15 – 14:30 Mbledhja 15 (M15): me Drejtorin.